

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Jonuz Bugari**, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve porot: **Mustafë Cena** dhe **Sakip Kryeziu**, anëtar të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të propozuesit F. M. nga fshati D., Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson i autorizuari U. M. nga fshati D., Komuna e Rahovecit, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, dhe propozueses V. B. e lindur në P., tani me vendbanim në fshatin D., Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson përfaqësuesi i saj i autorizuar Avokati Q. Q., për shkak të zgjidhjes së martesës me marrëveshje, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor jo publik, zbatimit të provave, pas këshillimit dhe votimit, më **11.09.2018**, morri këtë:

A K T G J Y K I M

ZGJIDHET ME MARRËVESHJE martesë në mes të propozuesit **F. M.**, i lindur më ..., dhe propozueses **V. B.**, lindur më ..., martesë e lidhur më ..., në Zyrën e Gjendjes Civile në Rahovec – Ç., Nr. ser. **M ...**, me nr. rendor ..., dhe me numër të referencës **16|2014RM|16009**.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit F. M. dhe V. B. nëpërmjet të autorizuarve të tyre, në këtë gjykatë kanë parashtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, kanë cekur se palët ndërgjyqëse, në këtë martesë nuk kanë të lindur fëmijë e as nuk presin lindjen e tyre, ngase nuk kanë krijuar bashkësi faktike, dhe se secili jeton ndaras sikurse edhe para lidhjes së martesës. Meqenëse sipas bindjes së palëve ndërgjyqëse, qëllimi i martesës në aspektin ligjor nuk është arritur, as që pritet në të ardhmen, palët konsiderojnë se kuptimi i martesës në mes të palëve ndërgjyqëse është humbur, dhe se të dy bashkërisht janë marrë vesh që kjo martesë të zgjidhet me marrëveshje për shkak të mungesës së bashkëjetesës.

Në lidhje me këtë çështje juridike gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 11.09.2018, në të cilën seancë është paraqitur i autorizuari i propozuesit të parë U. M. dhe përfaqësuesi i autorizuar i propozueses Avokati Q. Q..

I autorizuari i propozuesit të parë U. M. ka deklaruar se ngel në tërësi pranë propozimit duke shtuar se ndërgjyqësit janë martuar kah fundi të vitit 2009. të cilët kanë jetuar rreth 3 viteve bashkërisht, mirëpo për shkak të karaktereve të ndryshme dhe sëmundjes të njërit prej bashkëshortëve në prezencë të familjarëve të të dyja palëve, janë marrë vesh që bashkësinë martesore ta zgjidhin me marrëveshje, pa kërkuar njëri prej tjetrit kurfar kompensimi. Në këtë martesë nuk kanë pasur të lindur fëmijë e as që kanë mundur të presin fëmijë, e as që presin lindjen e fëmijës. Propozuesi i parë si rëndom jeton në familjen e babait të vetë, ndërsa propozuesja e dytë në familjen e babait të vetë ku edhe është lindur, dhe jeton me anëtarët të tjerë të familjes. Bashkëjetesa është shkëputur në fillim të vitit 2012. I propozoj gjykatës që propozimi i përbashkët për zgjidhjen e martesës ta miratojë si me bazë.

Përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit të dytë Av. Q. Q. deklaroi se palët ndërgjyqëse si që është cekur në propozim kanë lidhur kurorë në mënyrë formale në Zyrën e Gjendjes Civile më 02.12.2009, në këtë bashkësi formale si burë e grua nuk kanë lindur fëmijë, edhe pse kanë jetuar disa vite bashkërisht, por sipas të dhënave faktike nuk mund të lindin fëmijë dhe të njëjtit janë marrë vesh që ma mirë për të dyja palët në prezenc të familjeve të tyre këtë martesë ta zgjidhin formalisht dhe secili ta kërkojë fatin e vetë në të ardhmen, qoftë në bashkësinë martesore apo në bashkësinë jashtë martesore. Palët janë marrë vesh që asnjëri prej tjetrit mos të kërkojnë kompensimin, për që arsye në cilësi të propozueses V., martesën ta zgjedhë konformë nenit 68 të LPK-së, me propozim të përbashkët me marrëveshje secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Gjykata, për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave dhe atë: ka bërë shikimin e certifikatës së martesës Nr. ser. M ..., me nr. rendor ..., dhe me numër të referencës 16|2014RM|16009, e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, Ç., më 19.01.2018.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave, në bazë të bindjes së vetë të lirë, e duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së, është konstatuar se propozimi i përbashkët i propozuesve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, është i bazuar dhe i njëjti është aprovuar.

Me shikimin në certifikatën e martesës me nr. ser. M ..., e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec – Ç., më 19.01.2018, vërtetohet se F. M., i lindur më ..., dhe propozueses V. B., lindur më ..., martesë e lidhur më ..., në Zyrën e Gjendjes Civile në Rahovec – Ç..

Si fakt relevant në këtë çështje juridike gjykata muar për bazë se propozimin për zgjidhjen e martesës me marrëveshje palët e kanë bërë bashkërisht, nuk jetojnë së bashku që nga viti 2012.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë dhe duke u bazuar në dispozitat neneve 68, 69 dhe 84 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr. 32/2018, më 11.09.2018.

B. Profesional
Armond Omega

Kryetari i trupit gjykues
Jonuz Bugari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet ndërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit Divizioni Civil në Prishtinë.